



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1690/prot.
12

Tiranë, më 24.11.2021

V E N D I M

Nr. 49, datë 24.11.2021

“PËR

PROPOZIMIN E PAGESËS SË ORËVE SUPLEMENTARE

TË STAFIT AKADEMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UST, në VKM nr.748 datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në IPAL” të ndryshuar pika 7, në Udhëzimin e MASR nr. 29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, në shkresën e FVFR nr. 1505 prot, dt.21.10.2021 “Përcjellje e evidencave të realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2020-2021”; në shkresën e FSHL nr 1432 prot, dt. 12.10.2021“Përcjellje e evidencave të realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2020-2021”, në shkresën IKSHS nr. 1616, prot, dt. 09.11.2021“Realizimi i orëve mësimore, sipas mësimdhënies së normuar vjetore 2020-2021”, në shkresën e FSHR nr. 1602 datë 05.11.2021“Përcjellje e evidencave të realizimit të ngarkesës mësimore, për vitin akademik 2020-2021”, shkresën FVFR nr. 1554/1 datë 29.10.2021“Percjellje dokumentacioni për Prof.As.Dr.Bashkim Delia”, në Vendimin e Senatit nr 132 datë 24.11.2021“Për miratimin e propozimit e pagesës së orëve suplementare të stafit akademik , për vitin akademik 2020-2021, Bordi i Administrimit , në mbledhjen e tij të datës 24.11.2021,

V E N D O S I:

1. Miratimin për pagesën e orëve suplementare të stafit akademik të tre njëjësive kryesore të UST, për vitin akademik 2020-2021, nga art 600.8 i buxhetit të Universitetit Sporteve të Tiranës, i planifikuar në miratimin e grandit, për vitin buxhetor 2021.

2. Miratimin për pagesën e stafit akademik për orën mësimore sipas pikës 7 të VKM nr. 748 datë 11.06.2009”Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në IPAL”, të ndryshuar.
3. Miratimin e pagesës së orëve suplementare deri në 100 orë të stafit të IKSHS, për vitin akademik 2020-2021 dhe në vijim.
4. Për stafin akademik që ju është miratuar grada apo titulli gjatë vitit akademik, të identifikohen orët që janë kryer pas këtij ndryshimi dhe të përcillen nga njësitë kryesore për pagesë të specifikuar.
5. Bashkangjitur dokumentacioni përkatës nga njësitë kryesore
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë kryesore, Administratori, Drejtoria e financës dhe buxhetit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në www.ust.edu.al dhe tek trasparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Hysen Domi

